



KOMUNA E GJAKOVËS

Republika e Kosovës - Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative
Uprava za Opšte, Administrativne Poslove

01 Nr./Br. 4131.01-32412
Data 28.11.2018
Gjakovë - Djakovica - Gjakova

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

I lidhur me dt. 29.11.2018, ndërmjet:

1. Komunës së Gjakovës të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës Ardian Gjini, në tekstin vijues Komuna;
2. Organizatës për Zhvillim Rural (OZHR) "Mëshqerra" - Prishtinë të cilën e përfaqëson Znj. Florentina Kida - Gërguri, drejtor, në tekstin vijues: (OZHR) "Mëshqerra".

Neni 1 Qëllimi

Ky Memorandum Bashkëpunimi ka për qëllim angazhimin e përbashkët për realizimin e projektit nga lëmia e blegtorisë për fermerët e Komunës së Gjakovës i cili projekt do të zgjas 2 vite (2018-2020), dhe do të përfshijë një kontingjent prej 30 krerëve të Mëshqerrave barrëse të racës Hollishtajn-Frizis (për 30 familje), si dhe impute të tjera bazike blegtorale-bujqësore (koncentrat për kafshe, vitamina minerale) dhe trajnime të nevojshme për këta fermerë.

Neni 2 Obligimet e Komunës

- 2.1. Komuna e Gjakovës do të sigurojë mjetet financiare në vlerë të përgjithshme prej 18.000.00€ për përkrahjen e aktiviteteve të parapara sipas agjendës së projektit gjatë muajit Dhjetor 2018 do të transferoj në xhirollogarinë e OZHR "Mëshqerra" (Raiffeisen Bank 1501130000416395) në shumën prej 9.000.00 €, ndërsa pjesën e mbetur të shumës prej 9.000.00 €, do të transferojë gjatë muajve Mars -Prill 2019.
- 2.2 Ndërsa fermerët përfitues do të participojnë në projekt me nga 400.00 € për krerë në shumën totale 12.000.00 €, të cilat mjete do të barten në xhirollogarinë e OZHR "Mëshqerra".

Neni 3

Obligimet e OZHR “Mëshqerra”

3.1 OZHR “Mëshqerra” do të realizoj projektin i cili projekt do të financohet nga Organizata “Bothar” nga Irlanda.

3.2 OZHR “Mëshqerra” gjatë muajit Dhjetor 2018, do të siguroj përmes donatorit NGO “Bothar” nga Irlanda 30 krerë mëshqerra barrëse për fermerët përfitues në Komunën e Gjakovës.

3.3 OZHR “Mëshqerra” gjatë këtyre dy viteve do të zbatojë projektin me fermerët dhe do të sigurojë asistencë teknike për këta fermerë.

3.4 OZHR “Mëshqerra” gjatë realizimit të projektit, do të përgatisë raporte të nevojshme për gjendjen e projektit.

Neni 4

Realizimi i projektit

Realizimi i këtij projekti të do të zgjas 2 vite (2018-2020) dhe do të përfshijë një kontingjent prej 30 krerëve të Mëshqerrave barrëse të racës Hollshtajn-Frizis.

Neni 5

Monitorimi i Projektit

Komuna e Gjakovës do të formoj një komisionin për të monitorimin e projektit për shpërndarjen e Mëshqerrave barrëse të racës Hollshtajn-Frizis dhe të përgatiten raporti final dhe pas përfundimit të raportit të kryhen pagesat sipas rekomandimit të komisionit.

Neni 6

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi është përpiluar në 2 kopje identike, prej të cilave nga një kopje iu dorëzohen palëve.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Ky Memorandum Bashkëpunimi paraqet vullnetin e lirë të palëve nënshkruese, të cilat zotohen se të njëjtin do ta zbatojnë me përpikëri dhe në pajtim me kornizën ligjore në fuqi, ndërsa obligimet e palëve rrjedhin pas nënshkrimit të këtij Memorandumi.

PALËT

Komuna e Gjakovës

Ardian Gëmi



OZHR “Mëshqerra”

Znj. Florentina Kida Gërguri

